

Audiovisual archives and the reality in the dictatorship

Abstract: *The paper explores the historical circumstances in which the audiovisual archive in the Institute of Cultural Anthropology and for the Study of Arts was founded. It considers not only the procedures of research in ethnomusicology but also the dictatorship and the directives of the authorities. Author Minga pays abundant attention to the procedures set for the audio recordings as well as to how ethnomusicology developed within the tight boundaries of the dictatorship.*

Keywords: *ethnomusicology, audio recordings, video recordings, audiovisual archive.*

Teknikat e regjistrimit dhe riprodhimit të tingullit kanë luajtur një rol thelbësor në marrëdhënien e njeriut me muzikën. Regjistrimi i parë zanor daton në vitin 1877 dhe në 2017 mbushen 140 vjet të ekzistencës së tij. Rëndësia e këtij revolucioni është shumëplanëshe dhe një ndër to ka të bëjë me proceset e ruajtjes së kësaj gjurme tingullore dhe studimin e saj si dokument. U vu re qysh herët roli që kishin teknikat e regjistrimit dhe riprodhimit të zërit, për të studiuar fenomene të lidhura me praktikrat orale, dhe sidomos ato muzikore. Bela Bartok, pioner në kërkimet e etnomuzikologjisë shprehej për rëndësinë e këtyre aparateve sa i takon kapjes së “çastësisë” së një melodie.¹ Koha i dha të drejtë konstatimit të tij. Prania e mjeteve të regjistrimit dhe riprodhimit të zërit ishte thelbësore në mënyrën si u zhvillua një disiplinë si etnomuzikologjia. Në një linjë të tillë mund të shohim edhe ngritjen, më 1899, të Phonogrammarchiv-it të Vjenës, një prej arkivave më të rëndësishëm kërkimorë në këtë fushë. Gjithsesi u desh të pritej deri në vitet '30 të shekullit XX, që struktura të tjera të ngjashme të vijonin. Zhvillimet e teknologjisë së tingullit të riprodhuar janë të lidhura gjithashtu edhe me filmin ose imazhet lëvizëse, të cilat u shfaqën rreth viteve 1890. Edhe kësaj here, arkivat e parë filluan të krijohen rreth viteve '30 të shekullit XX.²

1 Béla Bartok, *Scritti sulla musica popolare*, përg. Diego Carpitella Torino: Bollati Boringhieri, 1977: 50.

2 Të dhënat e mësipërme janë marrë nga Helen P. Harrison, “Audiovisual Archives

Një moment me rëndësi në drejtim të ndërgjegjësimit për statusin e tingullit dhe imazhit si object kulturor që duhet ruajtur shënohet në vitin 1980, pas rekomandimit të UNESCO-s për mbrojtjen dhe ruajtjen e imazheve lëvizëse.³ 27 tetori është data kur ky rekomandim hyri në fuqi dhe kremtohet si dita botërore e trashëgimisë audiovizuale, me një vëmendje të posaçme ndaj arkivave audiovizualë.⁴ Në vazhden e këtyre nismave është rritur edhe interesi studimor përkundrejt tyre, duke krijuar një hapësirë ku bëhen bashkë politikat mbi trashëgiminë kulturore që lidhen me një strukturë të tillë si UNESCO-ja, me ato të dijes shkencore në fusha të tilla si, etnomuzikologjia, antropologjia e historia.⁵

Brenda këtyre specifikave do duhej të vendosnim edhe arkivin audiovizual të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (në vazhdim IAKSA), i cili përmban një fond në zë dhe figurë rreth kulturës tradicionale shqiptare, kryesisht asaj muzikore. Arkivi është krijuar në vitin 1960, si pjesë e Institutit të Folklorit. Historia e tij ka dinamikat e veta, megjithatë periudha diktatoriale (1946-1992) mbetet, deri tani, periudha më e rëndësishme e ekzistencës së këtij arkivi. Si e tillë ajo kërkon vëmendje të posaçme, duke marrë parasysh qëndrimin që mbajti shteti dhe kultura totalitare ndaj fushave të tilla si folklori.

Në këtë kumtesë do të ndalemi te shqyrtimi i kësaj periudhe; duke u marrë me detajet e krijimit dhe zhvillimit të këtij arkivi. Do ta bëjmë një gjë të tillë duke ndjekur një rend kronologjik, që zgjat deri në fund të viteve '80. Me rënien e diktaturës, mbyllet një etapë e caktuar e historisë së këtij arkivi dhe që pasohet nga një situatë e cila solli të tjera problematike. Këto nuk mund të trajtohen këtu për vetë gjerësinë që merr objekti i studimit, por që nxitin, gjithsesi, shqyrtimin e këtij arkivi në kushtet e kulturës totalitare.

Regjistrimi zanor dhe etnomuzikologjia

Ekspeditat kërkimore në folklor kishin filluar të zhvilloheshin në mënyrë sistematike prej vitit 1947, kohë kur u themelua Instituti i shkencave dhe folklori u vendos ndër prioritetet kryesore të punës kërkimore. Pjesë e tij ishte edhe kultura muzikore tradicionale. Në një hark kohor rreth 12 vjeçar, u bë një punë e rëndësishme për mbledhjen, transkriptimin, arkivimin dhe

Worldwide". Në *Audiovisual Archives: A practical reader*, përg. Helen P. Harrison, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization.1997-1998: 183.

3 http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13139&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html (konsultuar për herë të fundit më 12.11.2017).

4 <https://en.unesco.org/wdah2017> (konsultuar për herë të fundit më 12.11.2017).

5 Shih për këtë: Alessandro Rigolli e Paola Russo, (përg.) *Il suono riprodotto. Storia, tecnica e cultura di una rivoluzione del Novecento*. Torino: Edt, 2007; Peter Stockinger (përg.) *Introduction to Audiovisual Archives*, DOI:10.1002/9781118562048, 2012.

botimin e materialeve. Në 1958, Zihni Sako, një nga figurat më përfaqësuese të studimeve mbi folklorin gjatë kësaj periudhe, raporton si vijon:

Punonjësit e sektorit të folklorit me ekspeditat vjetore, që kanë zgjatur për çdo vit me disa muaj, kanë bërë kërkime në shumë zona të paeksploruara. Deri në vitin 1958 janë bërë kërkime në rreth 500 qendra, duke mbledhur këngë legjendare, këngë historike, këngë lirike, përralla, proverba e gjë-e-gjëza. Në këtë mënyrë fondi i gjetur [kupto materialet e mbledhura para vitit 1947] jo vetëm që u pasurua në mënyrë të ndieshme, po u krijuan mundësitë e themelimit të “Arkivit të Folklorit Shqiptar”.⁶

Vërejmë që një punë e tillë kishte dhënë rezultate në nivelin gjuhësor. Ndonëse një pjesë e materialeve të radhitura në listën e Sakos ishin materiale muzikore, kjo përmasë e kulturës tradicionale, ose folklorit, siç cilësohej në atë periudhë, ishte pak e studiuar. Një gjë e tillë mund të vërehet nga botimet në *Buletin e Institutit të Shkencave* (prej 1957 *Buletini i Universitetit të Tiranës*) organi kryesor i kërkimit shkencor në vend, si dhe nga raportet e ekspeditave, botuar po këtu. Këto tregojnë qartë hapësirën e kufizuar të muzikës, në raport me gjuhën.

Në vitin 1957 studiues të Akademisë së Shkencave të Gjermanisë lindore në bashkëpunim me studiues të Universitetit të Tiranës, ndërmorën një ekspeditë kërkimore etnomuzikologjike të përqendruar kryesisht në jug të Shqipërisë. Drejtues i ekspeditës ishin dy etnomuzikologë: nga pala shqiptare Ramadan Sokoli, ndërsa nga ajo gjermane, Erich Stockmann. Ekspedita e vitit 1957 ishte thelbësore në zhvillimin e etnomuzikologjisë mbi baza shkencore. Falë këtij bashkëpunimi u hapën shtigje për zbatimin e metodologjive bashkëkohore të kërkimit në terren.⁷ Një nga aspektet më me rëndësi të saj ishte përdorimi i mjeteve për regjistrimin dhe riprodhimin e tingullit në terren, në një përpjekje për të përfshirë edhe fshatrat më të largëta. Materialet e ekspeditës përfshinë rreth 620 regjistrime, me një kohëzgjatje afërsisht 30 orë.⁸

Pavarësisht rëndësisë shkencore, kjo ekspeditë nuk merr ndonjë vëmendje specifike në botimet zyrtare të kërkimit shkencor si *Buletini i Institutit të Shkencave*, ndërkohë që kontributet ardhura prej saj u bënë

6 Zihni Sako. 1959. “Folkloristika shqiptare gjatë periudhës së çlirimit të atdheut.” *Buletini i Universitetit të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*, no. 4. 138-143, 1959: 139.

7 Eckehard Pistrick. “Academic collaboration in ideological frameworks behind the iron curtain. The German-Albanian Expedition of 1957.” *Ethnologie Française*. 2, 2017: 244-245.

8 Kjo krahas fotografive të shumta si dhe shënimeve etnografike. Doris Stockman, Wölfried Fiedler, Erich Stockman. *Albanische Volksmusik. Gesänge der Çamen*. Berlin: Akademie Verlag, 1965: 12.

në mënyrë të përveçuar.⁹ Ndërkaq, në vitin 1959, zhvillohet një ekspeditë tjetër në nivel bashkëpunimi, ekspedita shqiptaro-rumune. Por sërish nuk kemi ndonjë raport specifik dhe muzika vazhdonte të kishte të njëjtën pozitë të kufizuar në raportet e botuara të ekspeditave folklorike të bëra nga seksioni i folklorit pranë Institutit të Shkencave. Duhet të presim vitin 1960 që t'i jepej zgjidhje një prej “dobësive” të folkloristikës shqiptare, si vëren Zihni Sako:

Një dobësi në lëmin e folkloristikës shqipëtare kanë qenë kërkimet për muzikën dhe koreografinë popullore. Botimet e deritanishme të disa këngëve popullore të shoqëruara me muzikë nuk janë mjaft të mjaftueshme, ato nuk kanë zbuluar dot madhështinë dhe gjenin krijonjëse të popullit.

Partia dhe Qeveria e jonë edhe këtë detyrë të madhe përpara punonjësve të folklorit e zgjidh me vendimin që u muar në muajin Tetor të këtij viti për ngritjen e “Institutit të folklorit muzikor e gojor.”¹⁰

Në institutin në fjalë,

“[k]rahas grumbullimit e regjistrimit të melodive popullore, të valleve e këngëve, do të bëhet sistemimi shkencor i këtij materiali për të krijuar edhe arkivin e valleve e melodive.”¹¹

Instituti ka filluar punën në vitin 1961, ndërkohë që në vitin 1979, pas një reforme institucionale, ai ndryshon emërtim në Instituti i Kulturës Popullore, duke përfshirë brenda organikës sektorin e etnografisë dhe atë të folklorit.

Fondi i arkivit fillon në vitin 1961 dhe regjistri themeltar i arkivit organizohet mbi një rend kronologjik, vjetor. Në regjistrat e secilit vit shënoheshin numrat e bobinave në shirit dhe, në krah, të dhënat për interpretuesit. Regjistrimet e ekspeditave ishin gjithashtu dosjet e tyre me të dhëna mbi muzikantët dhe tekstin e transkriptuar, kryesisht me dorë. Gjeografia e Shqipërisë ishte thelbësore në të dhënat mbi regjistrimet.

9 Eckehard Pistrick e shpjego një gjë të tillë në kuadër të marrëdhënieve delikate që kishin edhe shtetet socialiste me njëri-tjetrin. Në kushte kur presioni politik dhe ideologjik ishte i madh edhe vetë puna shkencore nuk mund të zhvillohej në mënyrë neutrale. Eckehard Pistrick. 2017. “Academic collaboration in ideological frameworks behind the iron curtain. The German-Albanian Expedition of 1957. *Ethnologie Française*. 2, 241-252.

10 Zihni Sako, “Do të ngrihet instituti i folklorit,” *Nëndori* 11, 1960: 13.

11 A.F., “U krijua instituti i folklorit muzikor e gojor,” *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkenca shoqërore*, no. 4, 1962: 254-255.

Bobinat e para (rreth 150) përmbajnë materiale të prejardhura nga Radio Tirana. Duke parë natyrën e materialeve, mund të themi se këto nuk ishin regjistrime *in situ*, por ishin të trajtuara si performanca muzikore të tipit skenik. Prejardhja na lë të supozojmë që bëhej fjalë për material të fonotekës së Radio Tiranës, të cilat përdoreshin për transmetime radiofonike. Deri në atë periudhë, kjo e fundit duhet të ketë qenë enti i vetëm që zotëronte aparatura regjistrimi e riprodhimi të tingullit. Bëhet fjalë kryesisht për këngë të interpretuara nga muzikantë aktivë sidomos në hapësirat urbane të vendit, si Hafsa Zyberi, Bik Ndoja, Fitnete Rexha, Mustafa Bodini, por edhe Viktori Xhaça e Mynever Kallajxhi, dy emra që spikatën sidomos në transmetimet muzikore të Radio Tiranës. Materialet ishin të shoqëruara nga formacione instrumentale të vogla. Në atë periudhë, të gjithë në përgjithësi kishin filluar të angazhoheshin pranë institucioneve të sapoformuara si, për shembull, estradat qytetëse, shtëpitë e kulturës, ansambli i ushtrisë, kori i filarmonisë, kori i radios dhe radio Tirana afronte grupe të tillë për transmetimet muzikore.

Këtë fond të Radio Tiranës, Arjana Seiti e rendit si burimin e parë për krijimin e arkivit, ndërsa pas tij, ajo rendit regjistrimet e prejardhur nga ekspedita gjermane me rreth 530 njësi, sipas saj.¹² Materialet e ekspeditës në fjalë së bashku me ato të ekspeditës shqiptaro-rumune kanë rëndësi të veçantë për këtë moment të fillimit. Kjo pasi “sanksionojnë” profilin kërkimor shkencor të këtij arkivi me regjistrime *in situ* të cilat janë pjesë e punës së etnomuzikologut.

Ekspeditat në terren do të jenë një burim i vazhdueshëm për fondin e arkivit deri në fund të viteve ‘80. Në çdo vit kemi regjistrime të bëra në terren. I pyetur rreth mënyrës sesi zhvilloheshin këto ekspedita, studiuesi Ramazan Bogdani, i cili është njëkohësisht edhe ndër personat që ka përgatitur regjistrat themeltarë të arkivit audiovizual, vëren se ato ishin pjesë e planit të punës së çdo studiuesi të folklorit dhe ai zgjidhte vendet se ku do të shkonte. Kishte gjithashtu raste kur vendet për të bërë ekspeditë përcaktoheshin nga drejtoria e institutit. Kjo ndodhte atëherë kur zona në fjalë nuk kishin marrë vëmendjen e duhur nga folkloristët.¹³ Në të gjitha rastet, studiuesit ishin të pajisur me aparate regjistrimi të cilat i zotëronte instituti dhe materialet e mbledhura në terren hidheshin e sistemoheshin në bobinat përkatëse në arkiv. Trajtimi bëhej në bobina të mëdha dhe në shirita të vegjël, për lehtësi studimi.

Gjithsesi, fondi i këtij arkivi nuk u kufizua vetëm me ekspedita. Që në vitin 1961, aty u përfshinë gjithashtu regjistrime nga festivalet folklorike, të cilat përbënin një ndër aktivitetet më të rëndësishme në programin

12 Arjana Seiti, “Një vështrim historik mbi themelimin e arkivave shkencorë të IAKSA-s,” *Gjurmime Albanologjike*, 44, 321-332, 2014: 326-327.

13 Ramazan Bogdani. Bisedë personale. Dhjetor 2017.

kulturor të shtetit socialist. Folkloristët e etnomuzikologët kishin pjesën e vet në organizimin e ngjarjeve të tilla mbi “kriteret e duhura”. Do duheshin rreth 7 vjet që praktika e spektakularizimit të performancave tradicionale, të “sanksionohej” në mënyrë përfundimtare me Festivalin folklorik kombëtar të Gjirokastrës, edicioni i parë i të cilit u zhvillua më 1968. Ky festival përfaqësoi ngjarjen më të rëndësishme në kuadër të ideologjizimit të folklorit shqiptar gjatë periudhës diktatoriale.

Krijohet kështu një ndarje midis materialeve arkivore të prejardhura nga ekspeditat, me regjistrime *in situ* dhe atyre që vinin në mënyrë të spektakularizuar skenike, që vinin kryesisht nga festivalet lokale e kombëtare. Megjithatë, edhe brenda kësaj ndarjeje ka vend për komente pasi në disa raste vetë ekspedita konceptojë mbi format “e stilizuara” të spektaklit folklorik. Shembulli më kuptimplotë për këtë janë vallet tradicionale të cilat janë filmuar në një format që sot mund të përshkruhet si një lloj videoklipi. Këto regjistrime paraqesin performanca muzikore të kuruara paraprakisht si, për shembull, valltarë që kërcenin të veshur me kostume popullore, të filmuar jashtë, në një peizazh pastoral dhe duke qenë ata të vetmit protagonist të ngjarjes muzikore. Ka raste kur instrumentistët shoqërues nuk inkuadrohen në kamera.

Një tjetër element i arkivit është regjistrimi në studio, i realizuar brenda institutit të folklorit. Ekzistenca e një studioje regjistrimi lidhet me godinën ku ai ishte vendosur. Bëhet fjalë për një vilë në rrugën Kont Urani, në Tiranë, e cila përpara vitit 1961 kishte qenë godina e radio Tiranës. Si e tillë ajo ishte e pajisur me një studio transmetimi. Këto ambiente u përdorën edhe nga teknikët dhe studiuesit, për të bërë regjistrime të muzikantëve.

Një vend të konsiderueshëm në këtë fond, zë edhe i ashtuquajti “folklor i ri”, i cili u ngjiz nën drejtimin e aparatit ideologjik shtetëror dhe synimit për të krijuar “muzikën socialiste”. Folklori i ri ishte, sipas këtij synimi, “rezultat” i elementëve të rinj socialistë në moralin, kulturën dhe jetesën e njerëzve.¹⁴ Regjistrimet e këtij profili shpeshtohen nga vitet ‘70 e në vijim.

Nga kjo paraqitje përshkruese mund të nxjerrim disa përfundime: Së pari, praktikat muzikore ishin orientuar si pjesë e folkloristikës, disiplinë e prejardhur nga kërkimet mbi folklorin në kontekstin totalitar. Si rrjedhojë, narrativat nacionaliste ishin thelbësore në drejtim të regjistrimit të materialeve. Kemi materiale të pakta nga minoritetet etnike në vend, mbledhja dhe regjistrimi i të cilave mund të konsiderohet si tepër diskrete në raport me ato etnike shqiptare. Gjenden regjistrime të komuniteteve arbëreshe të realizuara nga ekspedita që janë bërë kryesisht në vitet ‘80, sikundër mungojnë ato të arvanitasve në Greqi. Ekspedita janë zhvilluar

14 Pa Autor, “Për zhvillimin e mëtejshëm të shkencave shoqërore,” *Buletin për Shkencat Shoqërore*, no. 3, 1955: 7.

gjithashtu edhe në Kosovë dhe Maqedoni në zonat shqipfolëse. Së dyti, del qartë rëndësia që kish arkivi në kërkimin shkencor; mund ta konsiderojmë si një institucion brenda institucionit; një hapësirë pa të cilën nuk mund të kuptohej ekzistenca e vetë institutit. Mund të thuhet se nga viti 1961 deri në vitin 1988 çështja e mbledhjes dhe arkivimit të materialeve muzikore mbetej prioritare. Ekspedita ose kërkimi në terren (*fieldwork*) lidhej ngushtë me arkivin dhe ky nuk është thjesht një depozitim, sesa një ndërmarrje në funksion të pasurimit të tij. Bëhej fjalë për një qasje akumulative, e cila realizohej sistematikisht. Terreni (ekspedita) na përvijohet kështu si një hapësirë eksteriorizimi e kujtesës; një vjelje e një ekstrakti, i cili do të sistemohej dhe arkivohej dhe më pas do të studiohej. Sa i takon nivelit teknik, mund të themi se regjistrimi realizohej në shirit magnetik; nuk pati përditësime me teknika apo aparate më bashkëkohore. Ndërkaq, mënyra sesi u artikulua folklori në periudhën totalitare ka bërë që të dokumentohen gjerësisht edhe ato forma spektakolarizimi të periudhës totalitare të cilat padyshim përbëjnë një interes studimi më vete.